



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 737 Prot.

Tiranë, më 07.03 2023

VENDIM
Nr. 33 datë 07.03 2023

PËR
PJESËMARRJEN E UST SI BASHKËORGANIZATOR
NË KONFERENCËN E 8-TË NDËRKOMBËTARE BALLKANIKE
TË SHKENCAVE SPORTIVE ME FAKULTETIN E KULTURËS FIZIKE,
UNIVERSITETI I TETOVËS, REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 'Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë', si dhe në Vendimin e Rektoratit nr. 23 datë 15/02/2023 "Për propozimin e pjesëmarrjes së UST si bashkëorganizator në Konferencën e 8-të Ndërkombëtare Ballkanike të Shkencave Sportive me Fakultetin e Kulturës Fizike, Universiteti i Tetovës, Republika e Maqedonisë së Veriut", Senati akademik në mbledhjen e tij të datës 07/03/2023,

V E N D O S I:

1. Miratimin e pjesëmarrjes së UST si bashkëorganizator në Konferencën e 8-të Ndërkombëtare Ballkanike të Shkencave Sportive me Fakultetin e Kulturës Fizike, Universiteti i Tetovës, Republika e Maqedonisë së Veriut.
2. Ky Vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.
3. Ky Vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim në website zyrtar të institucionit, si dhe Njësive Kryesore të UST për njohje dhe zbatim.

KRYETAR I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA

